

SALI KADRIA**ÇËSHËTJA E SHËN NAUMIT GJATË VITIT 1923 - QËNDRIMI
I FUQIVE TË MËDHA DHE I QEVERISË SË DREJTUAR
NGA AHMET ZOGU****Çështja e Shën Naumit gjatë vitit 1922**

Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene pasi kishte siguruar nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris, miratimin e rektifikimeve kufitare në favor të saj në sektorët e Dibrës, Podgoricës dhe Prizrenit¹, i vuri syrin edhe Shën Naumit. Qeveria jugosllave e mbante atë të pushtuar, me argumentin se ky territor iu njoh Serbisë në vitin 1913. Prandaj, deklaroi se nuk pranonte asnjë lloj diskutimi për këtë çështje². Gjithashtu, ajo doli me pretendimin se Shën Naumi dhe fshatrat përreth tij duhej t'i përkisnin Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, sepse banorët e tyre ishin të krishterë që i përkisnin kombësisë sllave³.

Qeveria jugosllave u përpoq t'i jepte një rëndësi të madhe manastirit të Shën Naumit me argumentin e lidhjes së ngushtë shpirtërore e fetare që kishte populli serb për këtë vend të shenjtë, por motivi i vërtetë që këmbëngulte për manastirin e Shën Naumit ishin interesat e saj ekonomike dhe strategjike. Zotërimi i Shën Naumit dhe hinterlandit të tij, i jepte mundësi shtetit jugosllav që të kishte kontrollin e rrugës Korçë-Pogradec-Elbasan, të liqenit të Ohrit dhe zonave të pasura përreth tij, si liqenin e Maliqit, zonën e Prespës e të Malit të Thatë. Me zbatimin e një projekti bonifikues, sektori i bujqësisë fitonte fushat e gjera pjellore të Pogradecit dhe Korçës. Ujërat e liqenit të Ohrit dhe të lumit Drin që buronte nga ky liqen, përbënin një pasuri të madhe kombëtare. Ato mund të përdreshin për prodhimin e energjisë elektrike për ndriçim, në sektorin e transportit, dhe në sektorë të tjerë të industrisë. Rezervat e

¹ *The British National Archives* (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/ 7331. A. Young për markezin Curzon të Kedleston, Beograd, 30 janar 1922.

² *Po aty*, FO 371/ 7327. Legata serbe për Foreign Office, Londër, 12 gusht 1922.

³ *Po aty*, FO 371/ 7327. Aide-Memoire e Legatës serbe në Londër për Foreign Office, Londër, 29 gusht 1922.

peshkut të këtij liqeni, mund të shërbenin për ripopullimin e peshqve në lumenjtë e të gjithë Evropës⁴. Koloneli francez André Ordion, i cili kishte shërbyer si oficer i trupave franceze në pjesën juglindore të Shqipërisë, gjatë Luftës së Parë Botërore, shprehej se “liqeni i Ohrit është më superior se liqenet zvicerane dhe italiane. Nëse ky vend do të ishte në duart e një kombi perëndimor, ai do të kthehej në një vend mjaft tërheqës për turistët dhe të sëmurët”⁵.

Një pjesë e Fuqive të Mëdha përmes lojërave diplomatike në Komisionin e Caktimit të Kufijve të Shqipërisë dhe në Konferencën e Ambasadorëve në Paris synonin të kënaqnin orekset territoriale të serbëve, të cilët kishin qenë aleatë të tyre gjatë “Luftës së Madhe”. Rolin kryesor në këtë drejtim e luanin Britania e Madhe dhe Franca, ku herë njëra dhe herë tjetra dolën në mbështetje të interesave jugosllave.

Gjatë vitit 1922, pengesë kryesore për zvarritjen e caktimit të vijës kufitare në zonën e Shën Naumit u bë përfaqësuesi britanik J. Giles, anëtar i Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë. Ai mendonte se në pikën 2 të projektit austro-hungarez të paraqitur më 8 gusht 1913 nga ambasadori Mensdorff në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, përcaktohej shprehimisht: “...Kazaja e vjetër osmane e Korçës bashkë me bregun perëndimor dhe jugor të liqenit të Ohrit, nga fshati Lin deri në manastirin e Shën Naumit janë integralisht pjesë të Shqipërisë”⁶. Pra, nuk përcaktohej qartë nëse shprehja “deri në” përfshinte apo jo Shën Naumin brenda kufijve të shtetit shqiptar⁷. Komisioneri britanik J. Giles, mendonte se, nëse Konferenca e Ambasadorëve e Parisit synonte t’ia jepte Shqipërisë territorin e Shën Naumit, ajo do ta kishte përshkruar në

⁴ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925. Shqipëria dhe Maqedonia*, vëll. I, shkrime të kolonelit André Ordion të përmbledhura nga Dominique Danguy des Déserts, përkthyer nga Tomi Nakuci, Luan Rama, Lorena Dedja, Tiranë: Botimet Papirus, 2014, f. 95, 359, 421-422, 467-468.

⁵ *Po aty*, f. 95-96.

⁶ *Österreich-Ungarns Aussenpolitik: von der Bosnischen Krise 1908 bis zum Kriegsausbruch 1914. (Teil 2: Diplomatische Aktenstücke, 27. Februar 1909 bis 31. August 1910) Veröffentlichungen der Kommission für neuere Geschichte Österreichs; Band 20*, Wien, Leipzig: Österreichischer Bundesverlag, (1930), dok. no. 8353, pp. 120-121.

⁷ Mehdi Frashëri, *Kujtime 1912-1933*, Tiranë: Omsca-1, 2005, f. 173; Monika Shoshori Stafa, *Çështja e Shën Naumit*, studim historiografik-dokumentues, Tiranë: Albas, 2008, f. 50-52.

mënyrë të ngjashme me rastin e Linit ose si në protokollin e vitit 1913⁸. I kapur pas kësaj fraze, J. Giles synonte që manastiri i Shën Naumit t'i kalonte shtetit jugosllav⁹.

Në mendimin përfundimtar që komisioneri britanik, J. Giles, i paraqiti Konferencës së Ambasadorëve në Paris, në fund të tetorit 1922, i mbeti besnik mendimit që manastiri i Shën Naumit duhej t'i lihej Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene¹⁰.

Komisioneri italian Enrico Tellini, i cili ishte njëherësh kryetari i Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë dhe komisioneri francez Perret, mendonin se protokollin e vitit 1913 ia kishte dhënë Shqipërisë manastirin e Shën Naumit. Ata shpreheshin se meqenëse në vendimin e datës 9 nëntor 1921 nuk ishte përcaktuar se cilit shtet duhej t'i përkiste Shën Naumi, kjo nënkuptonte se ky manastir duhej t'i mbetej Shqipërisë¹¹.

Në dokumentin final të paraqitur nga E. Tellini thuhej se, mbështetur në interpretimin strikt të protokollit të Konferencës së Londrës të vitit 1913 dhe të vendimit të 9 nëntorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris, si dhe duke marrë në konsideratë faktorët lokalë, etnikë dhe topologjikë të shqyrtuar me kujdes, manastiri i Shën Naumit duhej t'i jepej Shqipërisë¹².

Edhe komisioneri francez Perret, në relacionin e tij përfundimtar drejtuar Konferencës së Ambasadorëve, shprehej se, mbështetur në të dhënat e mbledhura në terren, manastiri i Shën Naumit ishte plotësisht i huaj për nga origjina për Jugosllavinë, ndërsa për arsye ekonomike, gjeografike dhe etnike, ky territor lidhej natyrshëm me Shqipërinë. Ai

⁸ TNA, FO 371/ 7330. Raport përshkrues i komisionerit britanik Kol. Liet. J. Giles në Komisionin e Caktimit të Kufijve për ngjarjet e ndodhura nga data 22 korrik deri më 9 shtator 1922, Kampi pranë Strugës, Maqedoni, 9 shtator 1922.

⁹ Po aty, FO 371/ 7327. Telegram i Foreign Office për H. C. A. Eyres në Durrës [që t'i transmetohej J. Giles], FO, 18 gusht 1922.

¹⁰ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës*, trajtesë dhe dokumente, përgatitur nga prof. dr. Kaliopi Naska, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, dok. nr. 22, f. 76-77. Mendim i komisionerit britanik Lt. kol. J. Giles, "Mbi dhënien e manastirit të Shën Naumit", drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 27 tetor 1922.

¹¹ TNA, FO 371/ 7330. Raport përshkrues i komisionerit britanik Kol. Liet. J. Giles në Komisionin e Caktimit të Kufijve për ngjarjet e ndodhura nga data 22 korrik deri më 9 shtator 1922, Kampi pranë Strugës, Maqedoni, 9 shtator 1922.

¹² *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës ...*, dok. nr. 24, f. 86-88. Mendimi i komisarit italian mbi dhënien e manastirit të Shën Naumit, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 28 tetor 1922.

theksonte se edhe në protokollin e Londrës të vitit 1913 përcaktohej se territori nga fshati Lin deri te manastiri i Shën Naumit që i përkisnin më parë ish kazasë së Korçës, do të ishte pjesë e Shqipërisë. Në këto kushte, ai arrinte në përfundimin se manastiri i Shën Naumit duhej t'i mbetej shtetit shqiptar¹³.

Konferenca e Ambasadorëve miratoi një rezolutë të posaçme më 6 dhjetor 1922, me të cilën i bëhej e njohur Komisionit të Caktimit të Kufijve si dhe qeverive shqiptare dhe jugosllave se Konferenca kishte vendosur që Shën Naumi t'i jepej Shqipërisë¹⁴. Presidenti i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Raymond Poincaré, njoftoi ministrin jugosllav më 23 dhjetor 1922 se Konferenca e Ambasadorëve kishte vendosur që Shën Naumi t'i mbetej Shqipërisë. Ndërkohë, Poincaré njoftonte edhe qeverinë shqiptare lidhur me këtë vendim, ndërkohë që i tërhiqej vëmendja kësaj qeverie se dhënia e Shën Naumit do të realizohej vetëm pasi të caktohej përfundimisht nga Komisioni i Caktimit të Kufijve, vija kufitare midis shtetit serbo-kroato-slloven dhe atij shqiptar¹⁵.

Megjithëse në pamje të parë dukej se çështja e Shën Naumit ishte mbyllur, vendimi i Konferencës së Ambasadorëve ndeshi në kundërshtimin jugosllav. Qeveria jugosllave nuk e pranoi këtë vendim, me pretendimin se Shën Naumi dhe fshatrat përreth tij banoheshin nga serbë. Ajo e quante manastirin e Shën Naumit një vend të shenjtë fetar për kombin serb. Qeveria jugosllave shfrytëzoi faktin se manastiri gjendej në duart e ushtrisë serbe. Për këtë arsye, ajo nuk pranoi t'ia dorëzonte Shën Naumin shtetit shqiptar dhe as t'i nënshtrohej vendimit të Fuqive të Mëdha¹⁶. Në këtë mënyrë, çështja e Shën Naumit gjatë vitit 1922 mbeti e pazgjidhur.

¹³ *Po aty*, dok. nr. 25, f. 91-92. Mendimi i komisarit francez mbi dhënien e manastirit të Shën Naumit, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Prizren, 28 tetor 1922.

¹⁴ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX (1920-1924)*, vëll. II, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2019, f. 225; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Tiranë: Botimet Dudaj, 2010, f. 337.

¹⁵ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 47, f. 127. Njoftim i Raymond Poincaré, president i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, drejtuar kryetarit të delegacionit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve, Paris, 25 dhjetor 1922.

¹⁶ *Po aty*, dok. nr. 49, f. 129. Kryeministri i Shqipërisë Ahmet Zogu, i drejtohet Ministrisë së Luftës, Tiranë, 22 janar 1923; *po aty*, dok. nr. 50, f. 130. Kryeministri i Shqipërisë Ahmet Zogu i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tiranë, 27 janar 1923; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 225.

Çështja e Shën Naumit gjatë vitit 1923 – Qëndrimi i Fuqive të Mëdha dhe i qeverisë së Ahmet Zogut

Kryeministri shqiptar Ahmet Zogu i kërkoi Ministrisë së Luftës të urdhëronte komandën e trupave ushtarake shqiptare në Elbasan që të zinin sa më shpejt vijën e kufirit që i përkiste Shqipërisë të caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve. Gjithashtu, i kërkoi Ministrisë së Punëve të Jashtme që të ndërmerre hapat e duhur diplomatikë pranë qeverisë jugosllave për lirim të kufirit në pjesën e Shën Naumit dhe kalimin e saj në dorëzimin e ushtrisë shqiptare¹⁷.

Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve ndeshi në kundërshtimin e ashpër të qeverisë jugosllave. Përballë kësaj situatë të vështirë, Fuqitë e Mëdha i sugjeruan qeverisë shqiptare idenë e një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis dy qeverive të interesuara. Sipas këtij sugjerimi parashikohej që, nëse Shqipëria do të hiqte dorë nga Shën Naumi dhe Vermoshi, qeveria jugosllave do t'i jepte Shqipërisë, zonën e Banishtës së Dibrës dhe të Hasit të Rrafshit*, në anën e Prizrenit. Me sa duket, në kushtet kur nuk kishte zgjidhje tjetër, qeveria shqiptare u detyrua të bënte këtë lëshim të vështirë. Ministri i Punëve të Jashtme, Pandeli Evangjeli, u bënte me dije selive diplomatike shqiptare jashtë vendit që në rast se qeveria jugosllave do ta pranonte propozimin e mësipërm, ajo shqiptare “do të ishte e lumtur t'i jepte fund kësaj çështjeje të ngelur pezull prej kohësh dhe do të përshëndeste me kënaqësi inagurimin e një epoke paqeje dhe harmonie të mrekullueshme midis dy vendeve tona”¹⁸.

Pavarësisht se qeveria shqiptare mori këtë vendim të vështirë, vetëm me qëllimin që t'i jepej zgjidhje përfundimtare çështjes së kufirit të Shqipërisë me Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene, qeveria jugosllave nuk pranoi as vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të Parisit për Shën Naumin, por as zgjidhjen e kompromisit të sugjeruar nga Fuqitë e

¹⁷ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 49, f. 129. Kryeministri i Shqipërisë, Ahmet Zogu, i drejtohet Ministrisë së Luftës, Tiranë, 22 janar 1923; *po aty*, dok. nr. 50, f. 130. Kryeministri i Shqipërisë Ahmet Zogu, i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tiranë, 27 janar 1923.

* Nga pikëpamja etnogeografike, krahina e Hasit ndahet në tri pjesë: në Hasin e Rrafshit ose Hasi i Butë, në Hasin e Brisë dhe në Hasin e Thatë ose Hasi i Gurit [S. K.].

¹⁸ *Po aty*, dok. nr. 51, f. 130-131. Pandeli Evangjeli, ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, i drejtohet të ngarkuarve me Punë në legatat shqiptare, Tiranë, 21 shkurt 1923.

Mëdha. Për pesë muaj, ajo nuk reagoi ndaj vendimit të Konferencës së Ambasadorëve për Shën Naumin. Kjo heshtje, shkruan studiuesi P. Milo, shpjegohet me faktin e zhvillimit të zgjedhjeve parlamentare në mars të vitit 1923 në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene, ku qeveria e Nikolla Pashiçit ishte e angazhuar në fushatë. Ndërkohë që Komisioni i Caktimit të Kufijve i kishte ndërprerë punimet për shkak të stinës së dimrit, qeveria jugosllave dërgoi një grup specialistësh që të kërkonin dokumente në arkivat e Londrës, të Vjenës dhe të vendeve të tjera, me synim gjetjen e fakteve të reja që të mund të përligjinin rihapjen e kësaj çështjeje¹⁹.

Më 6 prill 1923, qeveria jugosllave i dërgoi një protestë Konferencës së Ambasadorëve në Paris kundër qëndrimit të mbajtur nga Komisioni i Caktimit të Kufijve, që i kishte kaluar Shën Naumin, shtetit shqiptar. Akuza ndaj komisionit bëhej sa për “show”, sepse vendimi i tij ishte konfirmuar zyrtarisht nga vetë Konferenca e Ambasadorëve. Qeveria jugosllave deklaronte se për pjesën e kufirit që ndodhej në jug të liqenit të Ohrit, ajo i përmbahej me forcë pikëpamjes se kufiri aty ishte vendosur përfundimisht më herët, në përputhje me të drejtën dhe me faktet dhe se ai nuk mund të pësonte asnjë ndryshim. Ndër argumentet që parashtrroi qeveria jugosllave ishin: 1. Nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, duheshin marrë parasysh vetëm vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913 dhe korrigjimet e Konferencës së Ambasadorëve të Parisit të 9 nëntorit 1921. Ajo i konsideronte ndryshimet e 9 nëntorit 1921 si të vetmin lëshim, të cilin ajo u detyrua ta pranonte, por ato nuk kishin të bënin dhe as nuk preknin çështjen e kufijve në jug të liqenit të Ohrit. Për këtë arsye, qeveria jugosllave mendonte se në këtë pjesë, situata duhet të mbetej siç kishte qenë më parë. 2. Pas ultimatumit austro-hungarez të vitit 1913, ushtria serbe u tërhoq brenda vijës kufitare aktuale, ndërkohë qeveria austro-hungareze deklaroi se ishte e kënaqur dhe çështja u mbyll. Ndërkohë, edhe fuqitë e tjera ishin të kënaqura me këtë vijë kufitare dhe asnjëra prej tyre nuk e mohoi atë. 3. Në fund të vitit 1915, trupat armike austro-hungareze u ndalën deri në vijën kufitare ku ndodhen aktualisht trupat jugosllave. 4. Nga pikëpamja politike, Mbretëria e Serbisë me aleatët e saj kishte hyrë dhe dalë fituese e Luftës së Parë Botërore. Gjatë luftës, Fuqitë Aleate i kishin garantuar disa herë

¹⁹ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918 - 1927*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1992, f. 220.

solemnisht Mbretërisë Serbe integritetin tokësor të saj, prandaj do të ishte e vështirë të besohej që aleatët do ta mohonin atë sot pas një lufte fituese. 5. Nga ana administrative, ky rajon varej gjithmonë nga Ohri. 6. Në vështrimin etnografik, pothuajse e gjithë popullsia në këtë rajon ishte serbe. Madje, serbët ishin më të shumtë në numër në pjesën afër kufirit, brenda territorit të Shqipërisë, se sa shqiptarët në këtë rajon. Në këtë rajon ndodhej manastiri i Shën Naumit, një nga vendet e shenjta, më të vjetra dhe më të mëdha serbe, ku në shek. XI, dishepujt e apostujve sllavë Ciril dhe Metod përkthyen në gjuhën sllave, librat e shenjtë dhe përhapën krishtërimin te serbët dhe sllavët e tjerë. Për këto arsye, prestigji dhe nderi kombëtar nuk e lejonte qeverinë dhe popullin serb që të braktisnin vullnetarisht këtë tempull kombëtar dhe t'ia kalonin një vendi tjetër. Prandaj, qeveria jugosllave refuzonte në mënyrë kategorike ndryshimet e çdo lloji të kufirit në jug të liqenit të Ohrit dhe nuk mund të braktiste pikëpamjen e saj, e cila diktohej edhe nga kushtetuta e vendit²⁰.

Më 11 prill 1923, ndodhi një ndryshim në përbërjen e Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë. Qeveria franceze emëroi kolonelin André Ordion në këtë komision. Ai zëvendësoi nënkolonelin Perret²¹, i cili u shkarkua nga qeveria franceze, për shkak se gjatë vitit 1922, komisioneri francez doli në mbështetje të kolegut të tij italian dhe gjatë gjithë kohës mbajti një qëndrim të kundërt me komisionerin britanik, J. Giles. Ky i fundit, i kërkoi qeverisë britanike që të ndërhynte pranë qeverisë franceze për zëvendësimin e komisionerit francez²².

Koloneli francez A. Ordion kishte njohje me shefin e misionit britanik, nënkolonelin Giles, pasi të dy kishin marrë pjesë më parë në Komisionin e Caktimit të Kufijve serbo-bullgarë. A. Ordion, shprehej se, komisioneri britanik “për shkak të karakterit të tij të vështirë, kishte marrëdhënie shumë të këqija jo vetëm me paraardhësin tim, por ishte i ashpër me të gjithë. Ky ishte bashkëpunëtor jo fort i përshtatshëm, por që e njihje mjaft mirë punën e tij. Ishte anglez nga koka deri te maja e

²⁰ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 53, f. 134-136. M. Spalajkoviç, i Ngarkuari me Punë në legatën serbo-kroato-slllovene në Paris, i drejtohet R. Poincaré, president i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Paris, 6 prill 1923.

²¹ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 377, 399.

²² TNA, FO 371/ 7331. Raport përshkrues i komisionerit britanik Kol. Liet. J. Giles për ngjarjet e Komisionit të Caktimit të Kufijve nga data 3 nëntor deri më 11 dhjetor 1922, Beograd, 12 dhjetor 1922.

thonjve dhe pëlqente të citonte shpesh ‘Madhërinë e Tij Britanike’, pasi për të, nuk kishte asgjë sipër saj’²³.

Sipas udhëzimeve të marra nga Parisi zyrtar, Ordionit iu kërkua që të nisej menjëherë drejt Beogradit, ku duhej të takohej me delegacionin jugosllav dhe të arrinte në Korçë më 1 maj 1923²⁴. Komisioni i Caktimit të Kufijve u mbledh në maj të vitit 1923 në Korçë. Ai përbëhej nga delegacioni italian i drejtuar nga gjeneral Enrico Tellini, i cili ishte njëkohësisht kryetar i komisionit; toger Bonaccini, i cili mbante detyrën e adjutantit të kryetarit të komisionit; komisioneri britanik ishte koloneli J. Giles; koloneli Ordion, i sapo ngarkuar me detyrën e komisionerit përfaqësonte Francën në këtë komision; doktori italian Corti, ishte mjeku i komisionit; kapiteni francez de Limperani mbante detyrën e sekretarit të përgjithshëm të komisionit. Në komision merrnin pjesë gjithashtu, delegatët e shteteve të interesuara me cilësi konsultative, por jo me të drejtën e votës. Krahas tyre në këtë komision kishte adjutantë, hartografë, gjeodezë dhe topografë italianë, jugosllavë, grekë e shqiptarë, si dhe personeli i një niveli më të ulët, si sekretarë, daktilografistë e të tjerë²⁵.

Në fillim të majit 1923, komisioni hartoi programin e punës që do të realizohej deri më 20 shtator 1923, kur ishte vendosur kthimi i tij në Itali. Për të punuar më shpejt dhe sipas programit, komisioni kishte vendosur që vijën kufitare të Shqipërisë, të caktuar në vitin 1913, ta ndante në tre sektorë: 1. Sektori i kufijve të Shqipërisë së Veriut, i cili përkonte me kufijtë shqiptaro-malazezë të vitit 1913; 2. Sektori i kufijve lindorë të Shqipërisë që shtrihej në pjesën verilindore dhe lindore të Shqipërisë, përgjatë kufirit shqiptaro-jugosllav; 3. Sektori i kufijve jugorë të Shqipërisë ose kufiri shqiptaro-grek²⁶.

Kryetari i komisionit i kishte caktuar secilit prej tre komisionerëve, drejtimin e punës në njërin prej sektorëve të mësipërm. Nënkoloneli britanik J. Giles mori përsipër sektorin lindor; koloneli francez A. Ordion iu caktua të drejtonte punën në sektorin verior; gjenerali italian Tellini

²³ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 399.

²⁴ *Po aty*, f. 377-378, 379.

²⁵ *Po aty*, f. 398; Tajar Zavalani, *Histori e Shqipnis*, Tiranë: Phoenix & Shtëpia e Librit, 1998, f. 268-269.

²⁶ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Tiranë: Shtëpia botuese 55, f. 180; *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 384, 398.

mori përsipër drejtimin e punës në sektorin jugor²⁷. Koloneli Ordion mendonte se kjo lloj ndarjeje nuk ishte bërë rastësisht. Sipas tij, komisioneri britanik J. Giles, kishte simpati për serbët, prandaj kishte marrë sektorin më të lehtë. Në rast ndërlikimi të situatës, ai kishte mundësi që të tërhiqej në Beograd. Megjithatë, rrallë mund të ndodhte ose ishte thuajse e pamundur që një anglez të qëllohej apo të kërcënohej, sepse tashmë dihej kudo parimi që krimet e kryera ndaj një britaniku, kurdoherë do të gjenin ndëshkim²⁸.

Me sa duket, qeveria italiane i kishte rekomanduar gjeneral Tellini-t që të punonte në sektorin e kufijve të Shqipërisë me Greqinë. Meqenëse marrëdhëniet mes Greqisë dhe Italisë ishin të tendosura, A. Ordion i kishte kërkuar gjeneral Tellini-t se, ishte më mirë, që sektori i kufijve jugorë t'i besohej komisionerit britanik, pasi ai nuk do të ndeshte shumë vështirësi në marrëdhëniet me grekët. Gjeneral Tellini ishte përgjigjur se, gjatë vitit 1922, ai ishte prekur nga sëmundja e malaries në brigjet e lumit Buna dhe të liqenit të Shkodrës, prandaj kishte kërkuar që të punonte në sektorin jugor. Pas kësaj bisede, shprehej A. Ordion, kuptova se me të drejtën e pakufizuar të kryetarit të komisionit, Tellini kishte zgjedhur qëllimisht, pjesën e kufijve jugorë të Shqipërisë²⁹.

Komisioneri francez i vuri vetes si objektiv që “ta kthente në rrugën e duhur” komisionerin britanik Giles ose “ishullorin”, siç e quante ai, nëse do të përpiqej që të ndiqte një drejtim të pavarur. Në këto kushte, koloneli A. Ordion shfrytëzoi taktikisht faktin se ishte më i moshuari ndër komisionerët e Fuqive të Mëdha si dhe karakterin britanik, i cili nuk përputhej aspak me atë italian. Meqenëse, komisioni përbëhej vetëm nga tre anëtarë, ai e përdori këtë fakt, që të bëhej zot i situatës, duke ndikuar që peshorja të anonte nga “ana e duhur”. Për shkak të marrëdhënieve të ngushta të Francës me Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene, prania e tij në sektorin kufitar mes shtetit shqiptar dhe atij jugosllav ishte në interes të shtetit që përfaqësonte për të ndihmuar aleaten e saj sllave në Ballkan. Megjithatë, njohja e thellë e shqiptarëve me të cilët kishte luftuar, karakteri dhe e shkuara e tij ushtarake ndikuan që të mbante një qëndrim të balancuar, apo siç e quan ai “me letra të hapura”, në lidhje me çështjen e Shën Naumit³⁰.

²⁷ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 384.

²⁸ *Po aty*, f. 399.

²⁹ *Po aty*, f. 384.

³⁰ *Po aty*, f. 418.

Gjatë vitit 1923, qeveria franceze e mbështeti hapur shtetin jugosllav³¹. Ajo nxiti qeverinë jugosllave t'i kërkonte Konferencës së Ambasadorëve rishqyrtimin e vendimit, i cili i jepte Shqipërisë, manastirin e Shën Naumit. Nëndrejtori për Çështjet e Evropës në Drejtorinë Politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, Emmanuel de Peretti de la Rocca, porosiste kolonelin André Ordion që të ndërpriste punën, me qëllim që ndalonte vijimin e veprimtarisë së kolegëve të tjerë të komisionit. Shkaku ishte se, qeveria franceze dëshironte të kënaqte Serbinë, të paktën me manastirin e Shën Naumit³².

Qeveria jugosllave vijoi të mos i bindej vendimit të dhjetorit 1922, si dhe u përpoq me të gjitha mënyrat për të penguar punën në terren të Komisionit të Caktimit të Kufijve. Madje, gjatë takimeve me përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, delegati jugosllav kërcënonte me tërheqjen e tij nga Komisioni i Caktimit të Kufijve³³. Koloneli A. Ordion, shprehej se, kur shtrohej çështja e Shën Naumit dhe e Vermoshtit, delegatët jugosllavë njësoj si ata grekë përgjigjeshin se prisnin “udhëzimet e qeverisë së tyre”. “Për mendimin tim”, - theksonte ai, “ata kërkonin të fitonin kohë, duke menduar se e ardhmja punonte për ta”³⁴.

Pas verifikimeve në terren gjatë muajit maj 1923, nënkoloneli britanik Giles arriti në përfundimin se manastiri i Shën Naumit duhej t'i mbetej Shqipërisë. Sipas tij, vija kufitare mes dy shteteve duhej të kalonte nga gryka e Galicicës, duke ia lënë Shqipërisë katundet Lubanishtë dhe Peshkëpi. Koloneli francez Ordion mendonte se kjo grykë duhej të ishte vija kufitare ndarëse, duke ia lënë Shqipërisë, Shën Naumin³⁵.

Delegati shqiptar, Bajram Fevziu, dyshonte se, qëndrimi pozitiv i komisionerit francez lidhej me përpjekjet e qeverisë franceze për të joshur qeverinë shqiptare që të mos u jepte koncesione kompanive britanike dhe italiane në fushën e kërkimit të naftës. Gjenerali italian

³¹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 225.

³² *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 55, f. 139-140. E. de Peretti de la Rocca, diplomat në Ministrinë e Punëve të Jashtme franceze, i drejtohet Ministrisë së Luftës për kolonelin Ordion-in, komisioner francez në Komisionin e Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, Paris, 8 maj 1923.

³³ *TNA, FO 371/ 5732*. Telegram i ambasadës britanike në Paris për Foreign Office, Paris, 4 maj 1923; *po aty, FO 371/8532*. Ministri i Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene për Foreign Office, Londër, 31 maj 1923; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 225.

³⁴ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 419.

³⁵ *Po aty*, f. 447.

Tellini, mendonte se, fshati Lubanishtë duhej t'i mbetej Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene dhe vija e kufirit të dilte në majën e Malit të Thatë, duke kaluar nëpër kodrat e këtij vargmali, të arrinte në liqenin e Prespës³⁶.

Meqenëse Komisioni i Caktimit të Kufijve arriti unanimitisht në përfundimin se manastiri i Shën Naumit duhej t'i mbetej Shqipërisë, B. Fevziu i kërkoi Tellini-t, kryetarit të këtij komisioni që të pranohej teza shqiptare që fshati Lubanishtë t'i mbetej Shqipërisë, sepse ndonëse banorët e Lubanishtës dhe Peshkëpisë flisnin sllavisht, ata ishin shqiptarë për nga origjina. Banorët e këtyre fshatrave ishin martuar me vajza bullgare të katundeve të rrethit të Ohrit dhe me kalimin e kohës, një pjesë e tyre ishin sllavizuar. B. Fevziu argumentonte që në qoftë se njëri apo të dy katundet nuk do t'i mbeteshin Shqipërisë, shteti jugosllav do të nxiste popullsinë e tyre, për të shkaktuar ngatërresa midis postave kufitare të dy shteteve. E. Tellini u shpreh se kjo kërkesë ishte e padrejtë, pasi ajo ishte jashtë vendimit të Konferencës së Ambasadorëve dhe dëshirës së shfaqur nga popullsia e atyre fshatrave³⁷.

Ministri Fuqiplotë i Shqipërisë në Beograd, Ali Kolonja informonte qeverinë shqiptare se, megjithëse qeveria jugosllave për momentin nuk ishte duke krijuar intriga dhe probleme si në vitin 1920 dhe 1921, drejtuesit e qeverisë shqiptare nuk duhej të ushqenin shpresën se qeveria jugosllave do të bënte qoftë edhe sakrificën më të vogël të interesave të saj në favor të Shqipërisë. Qeveria jugosllave vazhdonte të ushtronte të gjithë influencën e saj pranë qeverisë franceze, për të ndryshuar vendimin e Konferencës së Ambasadorëve që ishte krejtësisht në favorin e shtetit shqiptar³⁸.

Në fund të muajit maj 1923, koloneli A. Ordion, njoftonte se, Komisioni i Caktimit të Kufijve kishte përfunduar punën e caktimit të kufijve në pjesën jugore të liqenit të Ohrit dhe se do të ishte vullneti i Konferencës së Ambasadorëve, që do të vendoste përfundimisht mbi këta kufij. Çdo shtet duhej të pranonte vendimet e kësaj "Gjykate Supreme". Ai mendonte se çështja e Shën Naumit i ishte paraqitur mirë Konferencës

³⁶ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 57, f. 143-145. Bajram Fevziu, delegati i Shqipërisë në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë në Korçë, i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, Korçë, 14 maj 1923.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ *Po aty*, dok. nr. 58, f. 145-146. Ali Kolonja, ministri Fuqiplotë i Shqipërisë në Beograd, i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, Beograd, 17 maj 1923.

së Ambasadorëve në Paris, pasi ishte studiuar mendimi i komisionerëve i paraqitur përmes raporteve të tyre të gjata, që i kishin dërguar kësaj konference³⁹. Ordion shprehej se “nisur nga njohja ime e thellë e këtyre vendeve, jam plotësisht i bindur që manastiri i Shën Naumit do të jetë shqiptar, pavarësisht se kjo mund të mos u pëlqejë miqve të mi serbë”⁴⁰.

Ministri jugosllav në Paris, deklaroi se, nëse territori i Shën Naumit kalonte nën sovranitetin e Shqipërisë, ky veprim do të shkaktonte acarim në shtetin jugosllav. Kryeministri jugosllav N. Pashiç, u shpreh se, nëse ishte e nevojshme, shteti jugosllav ishte i gatshëm të hynte në luftë për këtë çështje. Më 17 maj 1923, qeveria jugosllave dislokoi në manastirin e Shën Naumit 150 trupa ushtarake dhe ngriti aty një postë ushtarake të përbërë nga ushtarë rusë. Më 24 maj, forcat jugosllave arrestuan ekspertët topografë italianë, megjithëse këta të fundit ishin të pajisur me pasaporta që mbanin nënshkrimin e përfaqësuesit jugosllav në Komisionin e Caktimit të Kufijve⁴¹. Autoritetet ushtarake jugosllave ndaluan teknikun gjeodez shqiptar të kryente punimet në Shën Naum, duke e detyruar që të tërhiqej nga aty. Ndërkohë, qeveria jugosllave hapi një shkollë serbe brenda Shën Naumit si dhe caktoi një mësues për të mësuar të rinjtë e katundeve të afërta. Ajo dëboi priftin ortodoks shqiptar dhe në vend të tij solli një prift serb⁴².

Për lirimimin e Shën Naumit nga trupat jugosllave, drejtuesit e qeverisë shqiptare mendonin se duhej t’i kërkohej ndihmë Konferencës së Ambasadorëve. Xhemil Dino, ministri Fuqplotë i Shqipërisë në Paris, i sugjeronte qeverisë së tij se kishte të ngjarë që parashtrimi i kësaj çështjeje para Konferencës së Ambasadorëve mund të interpretohej nga Fuqitë e Mëdha, sikur drejtuesit e qeverisë shqiptare nuk e konsideronin të sigurtë faktin se Shën Naumi i përkiste Shqipërisë. Diplomati shqiptar, mendonte se, pavarësisht pranisë së trupave jugosllave, dhënia e Shën Naumit Shqipërisë, ishte një fakt i kryer dhe se qeveria jugosllave nuk do

³⁹ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 95, 386.

⁴⁰ *Po aty*, f. 95-96.

⁴¹ TNA, FO 371/ 8532. Raport i Kol. Liet. J. Giles, komisioner britanik në Komisionin e Caktimit të Kufijve, për ngjarjet nga data 19 maj deri më 16 qershor 1923, Korçë, 16 qershor 1923.

⁴² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej F.) 151, Viti (më tej: V.) 1923, Dosja (më tej: D.). 188, fl. 36. Shkresë e prefektit të Korçës, Loro Suma, drejtuar zyrës sekrete në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Tiranë, Korçë, 29 maj 1923.

të mund të kundërshtonte me armë Komisionin e Caktimit të Kufijve, kur ai do të shkonte atje, për t'i bërë shqiptarët “de facto” zotërues të këtij territori⁴³.

Komisioni i ngritur pranë Konferencës së Ambasadorëve për të shqyrtuar pretendimet serbe në lidhje me kufijtë e Shqipërisë, u mbledh më 29 maj 1923 nën drejtimin e diplomatit francez Jules Laroche, i cili mbante detyrën e drejtorit të Departamentit të Çështjeve Politike dhe Tregtare për Evropën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës. Nga diskutimet u shfaq mendimi se, përderisa Shën Naumi vijonte të mbahej nga trupat serbe, ishte e qartë se qeveria jugosllave kërkonte ta mbante atë me forcë. Përfaqësuesit u shprehën se megjithëse qeveria jugosllave ishte zotuar se, do të mirëpriste çdo lloj vendimi të Konferencës së Ambasadorëve, tashmë ajo refuzonte të pranonte vendimet e saj. Kjo dëshmonte se, ajo synonte që vijës kufitare me Shqipërinë t'i bëheshin ndryshime të thella në favor të saj. Qeveria jugosllave nuk dispononte fakte që provonin se klerikët e manastirit dhe banorët e fshatrave përreth, ishin serbë për nga origjina e tyre. Diplomatët britanikë kishin konstatuar se në vjeshtë të vitit 1922, kur nga Komisioni i Caktimit të Kufijve u diskutua çështja e Shën Naumit, përfaqësuesi jugosllav nuk kishte parashtruar për asnjë moment, argumente historike dhe ekletike në mbrojtje të tezës se manastiri i Shën Naumit duhej t'i përkiste shtetit jugosllav⁴⁴.

Çështja e Shën Naumit hyri në vorbullën e kontradiktave ndërmjet Fuqive të Mëdha, veçanërisht midis Britanisë së Madhe dhe Francës, për vendosjen e hegjemonisë në Evropën e pasluftës botërore. A. Ordion theksonte se “çështja e Shën Naumit bëri aq bujë sa ajo e Ruhr-it ose e Fiume-s”⁴⁵. Diplomacia franceze vendosi të tërhiqej nga vendimi i datës 6 dhjetor 1922⁴⁶. Gjatë një bisede që ministri francez në Beograd zhvilloi me Ali Kolonjën, ai i kishte folur diplomatit shqiptar lidhur me përfitimet

⁴³ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 61, f. 149-150. Xhemil Dino, ministër Fuqiptotë i Shqipërisë në Paris, i drejtohet Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, Paris, 26 maj 1923.

⁴⁴ TNA, FO 371/ 8532. Lord Crewe, përfaqësues britanik në Konferencën e Ambasadorëve, për Foreign Office, Paris, 31 maj 1923; *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 225.

⁴⁵ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 95-96, 421-422.

⁴⁶ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 207.

që do të kishte qeveria shqiptare, nëse ajo dëshironte të fitonte miqësinë e qeverisë jugosllave. Prandaj, për t'ia arritur këtij qëllimi, Shqipëria duhej të bënte sakrifica në çështjen e kufirit. A. Kolonja ishte përgjigjur se deri tani, Shqipëria kishte bërë sakrifica të shumta dhe se çështja e Shën Naumit ishte e një natyre ndërkombëtare. Diplomati shqiptar mendonte se meqenëse kryetari i komisionit, E. Tellini dhe komisioneri britanik, J. Giles, kishin vendosur që t'i përmbaheshin drejtësisë, intrigat e jugosllavëve nuk do të mund t'ia arrinin qëllimit⁴⁷.

Mungesa e stabilitetit të brendshëm politik të shtetit shqiptar u reflektua edhe në përbërjen dhe mënyrën e përfaqësimit të tij në Komisionin e Caktimit të Kufijve të Shqipërisë. Anëtarët e delegacionit shqiptar pranë Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë u ndërruan njëri pas tjetrit për motive të ndryshme. Në fillim u caktua në krye të këtij delegacioni Ali Pashë Kolonja, i cili i la vendin Hilë Mosit. Ky i fundit ia kaloi detyrën Bajram Fevziut. Pas përfundimit të Konferencës së Lozanës, në krye të delegacionit shqiptar pranë Komisionit të Caktimit të Kufijve u caktua Mehdi Frashëri. Krahas kryetarit të delegacionit shqiptar në të bënin pjesë togeri Dhimitër Kosturi, kapiteni francez Veaute, tekniku gjeodez Selim Zyma, topografët italianë Contarini e Scalera të angazhuar nga qeveria shqiptare si dhe disa ndihmës të tjerë. A. Ordion, shprehej se, delegati shqiptar Mehdi Bej Frashëri ishte njeri i ditur dhe me shumë kulturë, por që e mbrojti pa shumë entuziazëm çështjen shqiptare. Ndoshta kjo ndodhi, sepse ai nuk zotëronte shumë dokumente, për ta kryer me saktësi këtë punë⁴⁸. Ordion shprehej se, togeri shqiptar Dh. Kosturi nuk ishte larg vlerave që kishte Mehdi Frashëri. Ky oficer shqiptar kishte njohuri të admirueshme për të gjithë Shqipërinë dhe popullsinë e saj, ndërkohë që ai i njihnte mjaft mirë aktorët dhe vendimmarrësit kryesorë në viset jugore. Në thelb, ai ishte një oficer i aftë dhe i ndershëm, i cili aftësitë i vuri në shërbim të vendit të tij dhe të komisionit⁴⁹.

Qeveria shqiptare deklaroi se, ajo e konsideronte të zgjidhur përfundimisht çështjen e Shën Naumit pasi vendimi i Konferencës mbi kufijtë e Shqipërisë ishte i pakthyeshëm. Ajo pohonte se pala shqiptare

⁴⁷ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 69, f. 159-160, Ali Kolonja, ministër Fuqiptotë në legatën shqiptare në Beograd, i drejtohet Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, Beograd, 2 qershor 1923.

⁴⁸ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 415-416.

⁴⁹ *Po aty*, f. 456-457.

nuk do të pranonte në asnjë mënyrë parimin e kompensimit, sepse çështja e Shën Naumit ishte një domosdoshmëri absolute dhe vitale për shtetin shqiptar⁵⁰.

Ekspertët e Foreign Office zhvilluan një mbledhje të posaçme për çështjen e Shën Naumit. Sir Cecil Hurst, këshilltar ligjor në Foreign Office, shfaqti mendimin se, manastiri i Shën Naumit duhej t'i mbetej Shqipërisë. Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga lord Crewe, i cili mbante detyrën e ambasadorit britanik në Paris, Harold Nicolson, eksperti kryesor për çështjet lindore në Foreign Office u shpreh se, ky vend kishte më shumë rëndësi strategjike për shtetin jugosllav, por me sa dukej Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1913, synonte që këtë territor t'ia kalonte Shqipërisë. Shumica e anëtarëve të Komisionit të Caktimit të Kufijve kishin dalë me mendimin unanimit se Shën Naumi duhej t'ia kalonte Shqipërisë. Nicolson arriti në përfundimin se zgjidhja e kësaj “nyje gordiane” ishte që ky vend t'ia kalonte Shqipërisë⁵¹. Gjithashtu, u mor parasysh edhe vendimi i Konferencës së Ambasadorëve i dhjetorit 1922, i cili përcaktonte që Shën Naumi duhej t'ia përkiste Shqipërisë⁵².

Lordi Crewe, u shpreh se, përderisa teksti i vendimit të Konferencës së Ambasadorëve i dhjetorit të vitit 1922, parashikonte që Shën Naumi duhej të përfshihej në Shqipëri, si dhe mbështetur në përfundimin e ekspertëve të Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, qeveria britanike duhej të njoftonte Konferencën e Ambasadorëve se, ajo kishte arritur në përfundimin që Shën Naumi duhej t'ia kalonte shtetit shqiptar⁵³.

Qeveria shqiptare i dorëzoi një promemorie Konferencës së Ambasadorëve, në të cilën deklaronte se, nuk mund të besonte se konferenca mund t'ia rikthehej një vendimi të marrë më parë për çështjen e kufirit në jug të liqenit të Ohrit. Edhe pse Shqipëria kishte bërë sakrificat të reja gjatë përcaktimit të pjesëve të tjera të kufirit me shtetin jugosllav

⁵⁰ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 71, f. 163. Pandeli Evangjeli, ministër i Punëve të Jashtme, i drejtohet delegatit shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë, Tiranë, 7 qershor 1923.

⁵¹ *TNA*, FO 371/ 8532. Shënim i Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, FO, 6 qershor 1923.

⁵² *Po aty*, FO 371/ 8532. Shënim i John Field në protokollin e Foreign Office, FO, 5 qershor 1923.

⁵³ *Po aty*, FO 371/ 8532. Lord Crewe, përfaqësues britanik në Konferencën e Ambasadorëve për Foreign Office, Paris, 12 qershor 1923.

në sektorët C dhe D, ajo i kishte pranuar vendimet e Konferencës së Ambasadorëve pa paraqitur asnjë protestë, vetëm me qëllimin që të respektonte çdo vendim të Konferencës së Ambasadorëve. Por, shteti shqiptar dëshironte që edhe shtetet e tjerë të respektonin njësoj vendimet e kësaj konference. Qeveria shqiptare, theksonte se, manastiri i Shën Naumit ishte ndërtuar nga shqiptarët e Korçës me shpenzimet e tyre dhe se ai kishte qenë gjithnjë një vend i shenjtë për shqiptarët. Ky manastir gjendej dy kilometra afër rrugës që lidhte Korçën me Pogradecin si dhe pesë kilometra larg Pogradecit. Për të siguruar rrugën Strugë-Dibër në favor të shtetit jugosllav, Konferenca e Ambasadorëve vendosi pak kohë më parë, t'i hiqte shtetit shqiptar një pjesë të territorit të tij. Prandaj, qeveria shqiptare ishte e bindur se Konferenca e Ambasadorëve do ta konsideronte të drejtë vendimin që manastiri i Shën Naumit t'i mbetej Shqipërisë. Gjatë regjimit osman, Shën Naumi gjendej nën varësinë administrative të kazasë së Starovës dhe të sanxhakut të Korçës. Sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve, Starova dhe Korça i ishin bashkëngjitur Shqipërisë. Shën Naumi nuk ka patur ndonjë interes moral ose fetar për popullsinë e krahinës së Ohrit, ku tre të katërtat e së cilës ishin bullgarë⁵⁴.

Mbështetur në udhëzimet e qeverisë shqiptare, ministri Fuqiplotë shqiptar në Paris, Xhemil Dino, kundërshtoi me forcë rishikimin e vendimit të mëparshëm të Konferencës së Ambasadorëve për çështjen e Shën Naumit. Diplomati francez J. Laroche, i cili shquhej për prirjen e tij serbofile, i ishte përgjigjur atij se “na është bërë një kërkesë nga qeveria jugosllave dhe ne nuk mundemi të mos e marrim atë në konsideratë”. Diplomati shqiptar ishte shprehur se, “si mund të rishqyrtohej një çështje tashmë e zgjidhur dhe mbi të cilën ju të gjithë keni vendosur njëzëri?” Laroche ishte përgjigjur me cinizëm se “ka të ngjarë, të jemi gabuar në gjykimin tonë”. Në këto rrethana, Xh. Dino ishte kundërpërgjigjur, duke u shprehur se ndoshta keni gabuar edhe në çështjen e Dibrës, prandaj përse të mos rishikohej edhe ky vendim. I gjendur para këtij sugjerimi provokues, diplomati francez kishte heshtur. Xh. Dino, njoftonte se, pavarësisht që qeveria franceze deklaronte se ishte asnjënjëse, nuk mund të shprehej se ajo do të sakrifikonte interesat e aleates së saj për hir të

⁵⁴ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 72, f. 164-165. Memorie e legatës shqiptare në Paris, 12 qershor 1923.

Shqipërisë. Megjithatë, ai kishte besimin se “vetëm një mrekulli mund t’ua jepte serbëve Shën Naumin...”⁵⁵.

Konferenca e Ambasadorëve vendosi t’ia kalonte shqyrtimin e çështjes Komitetit për Çështjet Ligjore të Konferencës së Ambasadorëve të Parisit, i përbërë nga përfaqësuesit britanikë, francezë dhe italianë. Edhe në këtë komitet u shfaqën dallime në mendime mes përfaqësuesve të fuqive. Përfaqësuesi britanik dhe ai italian u shprehën për mbajtjen në fuqi të vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të datës 6 dhjetor 1922, ndërsa përfaqësuesi francez kërkoi ndryshimin e tij. Në këto rrethana, komiteti i propozoi Konferencës së Ambasadorëve që çështja t’i kalonte për shqyrtim një grupi ekspertësh të fushës juridike⁵⁶.

Konferenca e Ambasadorëve udhëzoi Komisionin e Caktimit të Kufijve që nëse nuk shfaqeshin kundërshtime të forta nga banorët vendas, t’ia kalonte manastirin e Shën Naumit, shtetit jugosllav. Mirëpo, pas shqyrtimit në terren, Komisioni i Caktimit të Kufijve arriti unanimisht në përfundimin se, mbështetur në arsye etnike, ekonomike dhe strategjike Shën Naumi duhej t’i mbetej shtetit shqiptar⁵⁷. Koloneli Ordion shprehej se për qëndrimin që kishte mbajtur në Komisionin e Caktimit të Kufijve në lidhje me Shën Naumin, ai ishte kërcënuar nga kryeministri francez Raymond Poincaré, i cili i ishte shprehur se në “këtë çast, nuk po ma lehtësoni detyrën” për këtë çështje⁵⁸.

Qeveria shqiptare vijoi të kundërshtonte rihapjen e çështjes së Shën Naumit me argumentin se Konferenca e Ambasadorëve kishte marrë vendim në favor të Shqipërisë në dhjetor 1922. Drejtuesit e qeverisë shqiptare u shprehën se nëse hapej kjo çështje, shqiptarët do të ndiheshin të fyer sepse kjo dëshmonte se punohej me dy standarde. Ahmet Zogu u shpreh se lëshimet që Komisioni i Caktimit të Kufijve i bëri shtetit jugosllav në sektorin pranë Gjakovës, mbështetur në argumente strategjike, shkaktuan pakënaqësi të madhe në mesin e shqiptarëve. Qeveria shqiptare protestoi ashpër kundër këtij vendimi të padrejtë, por ajo mori përgjigjen se vendimi i marrë njëherë nuk mund të ndryshohej

⁵⁵ *Po aty*, dok. nr. 73, f. 167-170. Xhemil Dino, ministër Fuqiptotë në legatën shqiptare në Paris, i drejtohet Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, Paris, 13 qershor 1923.

⁵⁶ A. Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare...*, f. 338.

⁵⁷ *Po aty*, FO 371/ 5732. Shënim i Harold Nicolson në protokollin e Foreign Office, FO, 15 qershor 1923.

⁵⁸ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 447.

më. Në këto kushte, qeveria shqiptare pranoi vendimin e Komisionit të Caktimit të Kufijve dhe atë të Konferencës së Ambasadorëve, me arsyetimin se nëse një vendim apelohej, do të kishte vonesa dhe grindje pa fund për çdo pjesë të kufirit. Ajo kërkoi që përderisa Fuqitë e Mëdha kishin marrë vendime të formës së prerë ndaj pretendimeve të Shqipërisë, atëherë ato duhej të ishin të po kësaj forme edhe për shtetin jugosllav. Ahmet Zogu deklaroi se, nuk ishte e drejtë dhe serioze, por as në përputhje me deklaratat e Konferencës së Ambasadorëve që një vendim i marrë nga kjo e fundit në favor të Shqipërisë të shqyrtohej për herë të dytë⁵⁹.

Qeveria franceze u vu tërësisht në mbështetje të pretendimeve të shtetit jugosllav. Çështja kishte arritur deri në atë shkallë sa edhe komisioneri britanik J. Giles, i pohonte qeverisë së tij se në Sekretariatit e Përgjithshëm të Konferencës së Ambasadorëve në Paris kishte rrjedhje informacioni. Megjithëse, komunikimet mes Komisionit të Caktimit të Kufijve dhe Konferencës së Ambasadorëve ishin sekrete, legata jugosllave në Paris ishte e informuar më parë se ambasadorët e tjerë të Fuqive të Mëdha lidhur me përmbajtjen e tyre⁶⁰.

Ahmet Zogu kishte informacione se përfaqësuesi francez J. Laroche në Konferencën e Ambasadorëve, ishte në favor të rihapjes së çështjes së Shën Naumit, por përfaqësuesi italian kishte shfaqur kundërshtimin e tij ndaj këtij veprimi. A. Zogu i deklaroi ministrit britanik H. Eyres se “në caktimin e kufijve në përgjithësi, Shqipëria ka humbur një pjesë të konsiderueshme të territorit të saj, duke u bërë një shtet i dobët dhe pa mbrojtje. Në këtë mënyrë, interesat e saj kombëtare kanë mbetur në mëshirën e fatit. Për këtë arsye, mua më duket se në këtë moment nuk ka gjë më të rëndësishme që të ketë përparësi drejtësia mbi padrejtësinë”⁶¹. Prandaj, A. Zogu i kërkoi ministrit Eyres që në emër të drejtësisë, qeveria shqiptare kërkonte mbështetjen e qeverisë britanike, pasi vetëm Britania e Madhe me autoritetin e saj mund të parandalonte rihapjen e kësaj çështjeje⁶².

⁵⁹ TNA, FO 371/ 8532. H. C. A. Eyres për markezin Curzon të Kedleston, Durrës, 12 qershor 1923.

⁶⁰ Po aty, FO 371/ 7331. Raport përshkrues i komisionerit britanik Kol. Liet. J. Giles, për ngjarjet e Komisionit të Caktimit të Kufijve nga data 3 nëntor deri më 11 dhjetor 1922, Beograd, 12 dhjetor 1922.

⁶¹ Po aty.

⁶² Po aty.

Sipas udhëzimeve të qeverisë shqiptare, përfaqësuesi i Shqipërisë në Paris, Xhemil Bej Dino deklaroi se, qeveria shqiptare e konsideronte absurde kërkesën për rihapjen e çështjes së Shën Naumit, për të cilën ishte marrë një vendim në vitin 1922. Xh. Dino akuzoi funksionarin francez, Laroche, se ai synonte që të merrej një vendim për Shën Naumin, i cili të ishte në favor të jugosllavëve. Xhemil Bej Dino u shpreh se qeveria shqiptare e konsideronte përfundimtar vendimin për Shën Naumin. Nëse nuk pranohej vendimi i dhjetorit 1922, atëherë qeveria shqiptare do të dilte kundër vendimeve të marra për kufirin lindor dhe pjesës në veri të liqenit të Ohrit, të cilat nuk ishin në favorin e saj⁶³. Harold Nicolson i shkruante ministrit britanik në Durrës se për çështjen e Shën Naumit, qeveria britanike do të ndiqte pikëpamjen e H. C. Eyres⁶⁴.

Më 19 qershor 1923, qeveria jugosllave i drejtoi një notë zyrtare kryetarit të Konferencës së Ambasadorëve në Paris. Bashkëlidhur notës, ajo paraqiste disa dokumente zyrtare të nxjerra nga arkivat e Vjenës për vendimin që mori Konferenca e Ambasadorëve në Londër në gusht 1913, i cili ishte në favor të pretendimit të saj për Shën Naumin. Me këto “dokumente të reja” ajo nuk sillte ndonjë gjë të re për sqarimin e kësaj çështjeje. Qeveria jugosllave shprehej se Shën Naumi nuk kishte qenë kurrë pjesë e kazasë së Korçës, por siç konfirmonin dokumentet osmane, ajo kishte qenë gjithnjë pjesë e kazasë së Ohrit. Ajo shprehej se vendimi i Konferencës së Ambasadorëve ishte marrë mbështetur në mendimin jo kompetent dhe arbitrar të Komisionit të Caktimit të Kufijve të vitit 1922, duke i dhënë Shqipërisë një territor që nuk i kishte takuar kurrë asaj. Qeveria jugosllave kërkoi ndryshimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve të muajit dhjetor 1922⁶⁵.

Më 20 qershor 1923, Xhemil Dino i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve se ajo nuk duhej të pranonte deklarata të tjera në lidhje me një çështje tashmë të zgjidhur dhe të mos rishqyrtohej një vendim, i cili ishte marrë në lidhje me kufijtë. Me këtë kërkesë, qeveria shqiptare kishte për synim që nëse Konferenca e Ambasadorëve vendoste të rishqyrtohej kjo çështje, pretendimet shqiptare të mos mund të liheshin

⁶³ *Po aty*.

⁶⁴ *Po aty*, FO 371/ 8536. Harold Nicolson për H. C. A. Eyres në Durrës, FO, 13 qershor 1923.

⁶⁵ *Po aty*, FO 371/ 8532. Notë e M. Spalaikoviç, i Ngarkuari me Punë i Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllavene në Paris, për Raymond Poincarés, president i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Paris, 19 qershor 1923.

mënjatë. Nëse vendosej të rihapej “loja”, Shqipëria do të ishte e para që do të kërkonte bashkimin e qytetit të Dibrës me shtetin shqiptar, mbështetur në argumente të njohura ndërkombëtarisht si: Dibra ishte një qytet krejtësisht shqiptar; vargmali që ndante Dibrën nga Serbia ishte kufiri natyror midis shtetit jugosllav dhe atij shqiptar; qyteti i Dibrës gjendej aktualisht në një gjendje të rëndë ekonomike, e cila vinte për shkak të shkëputjes së saj prej Shqipërisë. Përfaqësuesi shqiptar e mbyllte notën e tij, me kërkesën për evakuimin e trupave jugosllave nga Shën Naumi, krijimin e një zone neutrale deri në ditën kur Komisioni i Caktimit të Kufijve të procedonte me kufizimin e këtij rajoni. Kjo kërkesë synonte të nxiste Fuqitë e Mëdha për zbatimin e vendimit për Shën Naumin⁶⁶.

Kryeministri Ahmet Zogu njoftonte legatën shqiptare në Paris se mbështetur në informacionet që ai dispononte, Komiteti Teknik Gjeografik kishte miratuar raportin e Komisionit të Caktimit të Kufijve për të gjithë kufirin shqiptaro-greko-serb, me përjashtim të zonës së Shën Naumit dhe të Vermoshit. A. Zogu ishte i informuar se Britania e Madhe dhe Italia ishin në anën shqiptare për çështjen e Shën Naumit⁶⁷.

Mehmet Konica ndërhyri dy herë pranë Foreign Office. Më 11 korrik 1923, ai ishte informuar nga funksionarët e lartë të Foreign Office se kjo e fundit i kishte transmetuar mendimin ambadorit britanik në Paris se qeveria britanike dëshironte që çështja e Shën Naumit të përfundonte një orë e më parë. Më 1 gusht 1923, M. Konica u shprehu funksionarëve britanikë ankesën e tij në rast se Konferenca e Ambasadorëve do të anulonte vendimin e mëparshëm të saj, i cili i njihte Shqipërisë të drejtën mbi Shën Naumin. Funksionarët e lartë të Foreign Office i ishin përgjigjur diplomatit shqiptar se sado të pathemelta që mund të dukeshin objeksionet e Serbisë, Konferenca e Ambasadorëve në Paris nuk mund t’i hidhte poshtë ato, pa i verifikuar nga Komiteti për Çështjet Ligjore të Konferencës së Ambasadorëve në Paris. Por, diplomatët britanikë besonin se ky komitet nuk do të pranonte pikëpamjen serbe dhe se Konferenca e Ambasadorëve nuk do ta

⁶⁶ *Po aty*, FO 371/ 8532. Notë e Xhemil Dinos, të Ngarkuarit me Punë në legatën shqiptare në Paris, për Raymond Poincaré, president i Konferencës së Ambasadorëve në Paris, Paris, 20 qershor 1923.

⁶⁷ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 78, f. 186-187. Ahmet Zogu, kryetar i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, i drejtohet legatës shqiptare në Paris, Tiranë, 22 korrik 1923.

ndryshonte vendimin që kishte dhënë në favor të Shqipërisë. I shqetësuar për këto lëvizje diplomatike, M. Konica shprehej se “këto premtime nuk duhet ta na vënë në gjumë, por duhet të përgatitemi për të rrëzuar argumentet e Serbisë, në qoftë se komiteti i pranon si të drejta ato argumente”⁶⁸.

Deri në fillim të muajit gusht 1923, Konferenca e Ambasadorëve në Paris miratoi të gjithë kufirin shqiptar me përjashtim të sektorit midis Linit dhe Shën Naumit. Zvarritja e caktimit të vijës kufitare në këtë sektor ndodhi për shkak se përfaqësuesi francez Laroche në Konferencën e Ambasadorëve në Paris kërkonte me insistim rihapjen e çështjes së Shën Naumit⁶⁹.

Krahas pengesës franceze me sugjerimin e gjeneralit Tellini, Komisioni i Caktimit të Kufijve i kishte paraqitur konferencës një kufi që kalonte rreth 5 km përtej Shën Naumit në brendësi të shtetit shqiptar për rajonin midis Ohrit dhe Prespës. Me këtë lëshim, komisioneri italian kërkonte të bindte francezët që të pranonin kufirin që kalonte në përroin pranë Shën Naumit, duke ia lënë Shqipërisë, manastirin e këtij vendi. Ndërkaq, drejtori për Çështjet e Evropës në Ministrinë e Punëve të Jashtme franceze, J. Laroche, i kishte pohuar ministrit shqiptar në Paris, se Shën Naumi kishte një vlerë të madhe morale për serbët dhe se ai e dinte këtë pasi kishte jetuar në Maqedoni. Laroche kishte pohuar se nuk mund ta linte në heshtje padrejtësinë që u ishte bërë serbëve me vendimin e datës 6 dhjetor 1922. Xh. Dino i ishte kundërpërgjigjur se si ishte e mundur atëherë që Franca heshti përpara padrejtësisë së bërë ndaj Shqipërisë, duke i shkëputur Dibrën, qytet shqiptar nga të gjitha pikëpamjet dhe raportet. Diplomati francez ishte detyruar të konfirmonte përkatësinë shqiptare të Dibrës. Xh. Dino shprehej i dëshpëruar se padrejtësia që u bëhej shqiptarëve si dhe kundërshtimi në këtë moment i të drejtave të padiskutueshme të shqiptarëve mbi Shën Naumin lidhej vetëm me faktin se “ne jemi të dobët dhe fatkeqësisht të vegjëlit janë ende të destinuar të pësojnë peshën e të fuqishmëve”. Xhemil Dino do t’i deklaronte Laroche se, populli shqiptar nuk do ta përtypte lehtë

⁶⁸ *Po aty*, dok. nr. 80, f. 188-189. Mehmet Konica, ministër Fuqiplotë në legatën e shqiptare në Londër, i drejtohet Ahmet Zogut, kryetar i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, [Londër] 5 gusht 1923.

⁶⁹ *TNA*, FO 371/ 8533. Rue D’ Agnessean për Foreign Office, Paris, 2 gusht 1923.

padrejtësinë që do t'i bëhej, nëse rishikohej vendimi i dhjetorit të shkuar i Konferencës së Ambasadorëve⁷⁰.

Kryeministri A. Zogu deklaroi se çështja e përfshirjes së Shën Naumit në shtetin shqiptar nuk pranonte diskutime të mëtejshme, pasi për këtë çështje ishte vendosur dy herë në favor të Shqipërisë. Ai i deklaroi ministrit britanik H. Eyres se “nuk arrij të kuptoj përse njëra nga palët e interesuara për caktimin e kufirit duhej të favorizohej kaq shumë, përkundër asaj çfarë i ndodh vendit tim. Kjo nuk është as e ndershme dhe as e drejtë”⁷¹. Ndryshimi i qëndrimit të Konferencës së Ambasadorëve, theksoi A. Zogu, dëshmonte se njëra prej Fuqive të Mëdha dëshironte të favorizonte shtetin jugosllav dhe “nëse ndodh kështu, mendoj se edhe ne duhet të kemi të drejta të barabarta për mbrojtje”⁷². Ai u shpreh se kufijtë e Shqipërisë ishin të shenjtë për shqiptarët. Në këto rrethana të vështira, “ne i biem në prehër dhe i kërkojmë ndihmë qeverisë britanike. Prandaj, do t'u isha mirënjohës nëse ju do t'ia përcillnit pikëpamjen time qeverisë së Madhërisë së Tij, pasi kjo është çështje vitale për ne”⁷³.

Kërkesa e qeverisë jugosllave për të interpretuar nga pikëpamja ligjore, vendimin e datës 8 dhe 11 gusht 1913 të Konferencës së Ambasadorëve të Londrës u pranua nga Konferenca e Ambasadorëve në Paris. Më 21 shtator 1923, çështja e Shën Naumit u diskutua në Komitetin për Çështjet Ligjore të Konferencës së Ambasadorëve në Paris⁷⁴. Qeveria jugosllave insistonte në mendimin që Protokollin i Londrës ia jepte këto vende Serbisë. Aty u paraqit propozimi britaniko-italian që i linte Shën Naumin, Shqipërisë. Delegacioni francez vazhdoi të mbronte interesat serbe dhe formuloi kundërshtimin e saj njësoj siç ishte formuluar nga qeveria jugosllave.

Më 21 dhe 23 shtator 1923, popullsia e Shkodrës, Korçës dhe e Vlorës protestuan pranë përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha kundër pretendimeve të reja të shtetit jugosllav për një copëtim të ri të tokave

⁷⁰ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 83, f. 193-197, Xhemil Dino, i Ngarkuari me Punë në legatën shqiptare në Paris, i drejtohet Ahmet Zogut, kryetarit të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, Paris, 17 gusht 1923.

⁷¹ TNA, FO 371/ 8534. H. C. A. Eyres për markezimin Curzon të Kedleston, Durrës, 27 shtator 1923.

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Po aty*.

⁷⁴ *AQSH*, F. 35, V. 1923, Kutia (më tej: K.) 3, D. 36/4, fl. 816-817. Letër e Mehmet Konicës, drejtuar Mid'hat Frashërit, Londër, 27 tetor 1923.

shqiptare. Banorët e këtyre qyteteve kërkuan që Shqipërisë duhej t'i mbeteshin Vermoshi dhe Shën Naumi⁷⁵.

Më 23 shtator 1923, Britania e Madhe i propozoi Konferencës së Ambasadorëve që Komisioni i Caktimit të Kufijve të Shqipërisë duhej të mbaronte punë me kufirin e saj verior, përpara se të fillonte dimri dhe më pas të merrej me kufirin e jugut, por propozimi i saj nuk u miratua. Në fillim të muajit tetor, Mehmet Konica u takua me zyrtarët e Foreign Office dhe u shprehu atyre mendimin se Komisioni për Çështjet Ligjore nuk mund të kishte kompetencë teknike, pasi Komisioni i Caktimit të Kufijve ishte kompetent për këtë çështje. Vonesa e zgjidhjes së kësaj çështjeje, vinte nga dëshira e ndonjë Fuqie të Madhe, që t'i jepej Shën Naumi, Serbisë. Ai u kishte kërkuar zyrtarëve britanikë që të udhëzonin ambasadorin e tyre në Paris, për t'i dhënë një zgjidhje të shpejtë në favor të Shqipërisë, ashtu siç e kërkonte e drejta⁷⁶.

Më 11 tetor 1923, Konferenca e Ambasadorëve vendosi që Komisioni i Caktimit të Kufijve t'i dorëzonte asaj të gjitha informacionet e vlefshme në lidhje me manastirin e Shën Naumit së bashku me argumentet përkatëse të secilit anëtar të këtij komisioni. Gjithashtu, ajo i kërkoi këtij komisioni të shtynte punën për kufizimin e vijës kufitare në sektorin e Shën Naumit deri sa Konferenca e Ambasadorëve të merrte një vendim lidhur me të⁷⁷.

Në përgjigje të kërkesës së Mehmet Konicës për njohjen e situatës në të cilën ndodhej çështja e Shën Naumit, diplomati britanik Alexander Cadogan, i cili drejtonte seksionin që merrej me Lidhjen e Kombeve në Foreign Office, i përgjigjej se çështja e Shën Naumit i ishte paraqitur më 21 shtator 1923 këshilltarëve ligjorë dhe se në Konferencën e Ambasadorëve ishin pezulluar diskutimet e mëtejshme për këtë çështje. Cadogan u shpreh se Konferenca e Ambasadorëve nuk mund të merrte

⁷⁵ TNA, FO 371/ 8534. Telegramë nga popullsia e Korçës me nënshkrimin e Vasil Avramit, e popullsisë së Shkodrës me nënshkrimin e Musa Jukës, të argjipeshkvit të Shkodrës, Lazër Mjeda dhe e Vlorës me nënshkrimin e Qazim Kokoshit, 21 shtator 1923; "Zëni i Shkodrës për malci e Shën-Naum", në *Ora e Maleve*, nr. 25, Shkodër, 29 shtator 1923, f. 1-2.

⁷⁶ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 91, f. 219-220. Mehmet Konica, ministër Fuqiptotë në legatën shqiptare në Londër, i drejtohet Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, [Londër], 3 tetor 1923.

⁷⁷ *Po aty*, dok. nr. 92, f. 220. Rezolutë: Dhënia e manastirit të Shën Naumit, [Paris], 11 tetor 1923.

asnjë vendim pa u shqyrtuar çështja nga ekspertët ligjorë dhe pa marrë mendimin e tyre⁷⁸.

Mehmet Konica kritikonte qeverinë shqiptare për faktin se kur qeveria franceze i kishte kërkuar koncesionin për të kryer gërmime arkeologjike në Shqipëri, ajo duhej t'ia kishte kushtëzuar dhënien e tij me garantimin e votës së saj në favor të çështjes së Shën Naumit dhe të Vermoshit. I shqetësuar, M. Konica shkruante se, “relacionet politike dhe ekonomike bazohen kurdoherë mi principin ‘më jep, të të jap’”. Ai mendonte se, rreziku që shqiptarët ta humbisnin Shën Naumin vazhdonte të mbetej i pranishëm. Sipas tij, “fitimin mund ta sjellë një propagandë e përdorur mirë dhe grushti, po mjerisht grushti ynë është i dobët dhe vleftën e propagandës nuk e kemi çmuar kurrë”⁷⁹.

Pas ardhjes në krye të Komisionit të Caktimit të Kufijve të Shqipërisë të gjeneralit italian Pietro Gazzera, i cili zëvendësoi E. Tellinin e vrarë në mesin e muajit tetor, komisioni vendosi të zgjaste punimet e tij në terren deri më 30 nëntor 1923⁸⁰. Më 24 tetor 1923, Konferenca e Ambasadorëve iu drejtua këshilltarëve ligjorë me kërkesën që të bënin një interpretim të protokollit të vitit 1913. Mirëpo, as këshilltarët nuk qenë në gjendje që të jepnin një mendim të prerë. Nga njëra anë, ata shpreheshin se Shën Naumi nuk duhej t'i mbetej shtetit shqiptar, nga ana tjetër, e quanin të pamundur një rishikim të vendimit të 6 dhjetorit 1922 të Konferencës së Ambasadorëve, sepse kjo do të krijonte një precedent të rrezikshëm⁸¹. Mehmet Konica sqaronte qeverinë shqiptare se këshilltarët ligjorë lanë mënjane pretendimin serb, i cili mbështetej në Protokollin e Londrës, pasi Konferenca e Ambasadorëve në Paris nuk do të kishte të drejtë të bënte të gjithë ato rektifikime kufitare në favor të Serbisë. Ai shprehej se “këtu [në Londër – S. K.] janë në favorin tonë mbi këtë punë, po në Paris mbrojnë me forcë pikëpamjen e Serbisë”. M. Konica shprehej se i kishte shkruar ministrit të Jashtëm, Pandeli

⁷⁸ TNA, FO 371/ 8534. Alexander Cadogan për Mehmet Bej Konicën, ministër i Shqipërisë në Londër, FO, 18 tetor 1923; *Po aty*, Telegram i ambasadës britanike për FO, Paris, 20 tetor 1923.

⁷⁹ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 93, f. 221-222, Mehmet Konica, ministër Fuqiptotë në legatën shqiptare në Londër, i drejtohet Pandeli Evangjelit, ministër i Punëve të Jashtme në Tiranë, Londër, 20 tetor 1923.

⁸⁰ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 407.

⁸¹ A. Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare...*, f. 338; P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927...*, f. 228.

Evangjeli se “Shën Naumi është në rezik, dhe në e humbshim është nga mos përdorja mirë e çështjes”⁸².

Më 29 tetor 1923, qeveria shqiptare nën drejtimin e Ahmet Zogut, e shqetësuar nga njoftimi për çështjen e Shën Naumit e të Vermoshit, u kërkoi përfaqësuesve shqiptarë të atashuar pranë qeverive të Fuqive të Mëdha që t’u bënin të ditur atyre se qeveria shqiptare nuk do të pranonte në asnjë mënyrë, një vendim tjetër mbi çështjen e Shën Naumit e të Vermoshit në favor të shtetit jugosllav. Meqenëse Konferenca e Ambasadorëve kishte vendosur dy herë që ato t’i mbeteshin shtetit shqiptar, qeveria shqiptare nuk do ta pranonte caktimin e kufirit, si dhe kishte për të kërkuar korrigjime të reja mbi shumë pika të vijës kufitare, të cilat ishin troje shqiptare të sakrifikuara padrejtësisht në dobi të Jugosllavisë⁸³.

Ministri Fuqiplotë i Shqipërisë në Paris, Xhemil Dino i deklaroi Konferencës së Ambasadorëve se Shqipëria nuk pranonte asnjë diskutim tjetër në lidhje me Shën Naumin dhe Vermoshin. Ajo nuk do të pranonte më gjymtime të reja të trojeve të saj, sepse çdo ndryshim territorial në favor të shteteve fqinje, jo vetëm që kishte karakterin e një padrejtësie të dukshme përkundër një shteti të vogël, por në të njëjtën kohë, vendime të padrejta të kësaj natyre, po nxisnin shtetet fqinje që të mos njihnin parimet mbi të cilat bazohej padhunshmëria e vendimeve të Fuqive të Mëdha. Qeveria shqiptare pohonte se në rast të kundërt, ajo nuk do të pranonte kufirin e ri me shtetin jugosllav dhe do të kërkonte korrigjime për disa territore që i ishin shkëputur Shqipërisë në favor të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene⁸⁴.

Me anë të një note zyrtare, që ministri Fuqiplotë i Shqipërisë në Londër, Mehmet Konica, i drejtoi sekretarit britanik të Shtetit, lordit Curzon të Kedleston, ai shprehej se në vitin 1913, një pjesë e madhe e territoreve shqiptare me mbi një milionë shqiptarë iu dhanë Serbisë, duke e ditur që këta të fundit do të kishin fatin e keq të shfarosjes së ngadaltë e

⁸² *AQSH*, F. 35, V. 1923, K. 3, D. 36/4, fl. 816-817. Letër e Mehmet Konicës, drejtuar Mid’hat Frashërit, Londër, 27 tetor 1923.

⁸³ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 94, f. 223. Vendim i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nr. 521, datë 29 tetor 1923, Tiranë, 29 tetor 1923.

⁸⁴ *Po aty*, dok. nr. 95, f. 223-224. Xhemil Dino, ministri Fuqiplotë në legatën shqiptare në Paris, i drejtohet Raymond Poincaré, president i Këshillit dhe ministër i Punëve të Jashtme të Francës, Paris, 5 nëntor 1923; Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë (1912-1939)*, vëll. I, Tiranë: Toena, 2013, f. 559.

të plotë. Ndërkaq, Konferenca e Ambasadorëve në Paris ishte duke vazhduar të njëjtën rrugë si ajo e Londrës, duke i dhënë pjesë të mëdha të territorit shqiptar, Serbisë. Shqipërisë po i bëheshin padrejtësi të vazhdueshme. Për territorin në perëndim të Prizrenit që iu dha shtetit jugosllav, u përdor argumenti se këtij të fundit i duhej për t'u mbrojtur në rast sulmi nga Shqipëria, pa marrë parasysh faktin se Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene ishte një shtet me një popullsi 15 herë më të madhe se Shqipëria. Për zonën kufitare Strugë-Dibër e Madhe, u përdor argumenti se kjo rrugë i duhej shtetit jugosllav për të lidhur këto dy qytete, pa menduar se shteti jugosllav kishte mundësinë ekonomike për të ndërtuar pak më tej një rrugë tjetër. Serbia e pakënaqur me këto lëshime të konsiderueshme kërkonte tani të përvetësonte Vermoshin dhe manastirin e Shën Naumit⁸⁵.

Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Pandeli Evangjeli, u kërkoi përfaqësive diplomatike jashtë vendit që të përpiqeshin me të gjitha mënyrat për të penguar një copëtim të ri të vendit. Ai theksonte se “me rektifikimet që Konferenca e Ambasadorëve pranoi për dëm të vendit t'onë dhe në favor të Jugosllavisë, takoi limiten e fundit të therorësisë që mund t'i impononte shtetit shqiptar”. Prandaj, P. Evangjeli i udhëzonte që të “mos kursenin asnjë mundim për triumfin e tezës s'onë...”⁸⁶.

Koloneli A. Ordion, mendonte se, nëse qeveria shqiptare nuk i kushtoi Shën Naumit ndonjë rëndësi të veçantë gjatë vitit 1922, këmbëngulja e saj për këtë territor gjatë vitit 1923, dëshmonte, ndër të tjera, se shqiptarët e mbronin këtë çështje edhe për sedër kombëtare⁸⁷. Duke parë përpjekjet e shqiptarëve për ngritjen e shtetit dhe mbrojtjen e viseve të tyre kombëtare, ai shprehej se “viti 1923 që po përfundon, do të konsiderohet një nga vitet më të mira të Shqipërisë”⁸⁸. Mbështetur sa më sipër, arrihet në mendimin se gjatë vitit 1923 qeveria shqiptare e drejtuar

⁸⁵ *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës...*, dok. nr. 100, f. 232-234. Mehmet Konica, ministër Fuqiptotë në legatën shqiptare në Londër, i drejtohet markezit Curzon të Kedleston, sekretar Shteti i Britanisë së Madhe, Londër, 24 nëntor 1923.

⁸⁶ *Po aty*, dok. nr. 102, f. 237-238. Pandeli Evangjeli, ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, i drejtohet legatave shqiptare në Londër, Paris dhe Romë, Tiranë, 30 nëntor 1923.

⁸⁷ *Një oficer francez në Ballkan 1917-1925...*, f. 95, 96, 421-422.

⁸⁸ *Po aty*, f. 123.

nga Ahmet Zogu bëri të gjitha përpjekjet e mundshme për të mbrojtur tërësinë territoriale të shtetit shqiptar.

S u m m a r y

THE QUESTION OF SAINT NAUM TERRITORY DURING 1923 - THE ATTITUDE OF THE GREAT POWERS AND THE ALBANIAN GOVERNMENT LED BY AHMET ZOGU

On December 6, 1922, the Conference of Ambassadors in Paris decided that St. Naum should be given to Albania. The Yugoslav government opposed this international decision, claiming that St. Naum was a religious shrine for the Serbian nation.

The Albanian government stated that it considered the question of St. Naum to be finally resolved, because the decision of the Conference of Ambassadors on the borders of Albania was irreversible. She emphasized that the monastery of St. Naum was built by the Albanians of Korça, at their expense and that it had always been a holy place for Albanians. Also, this territory was located two kilometers near the national road that connected the city of Korça with Pogradec and its passage under Yugoslav control threatened the security of the Albanian state.

If during 1922 the position of the British government was more in favor of the Yugoslav side on the issue of St. Naum, during 1923, the French government openly supported the Yugoslav state in this regard.

Therefore, at the end of September 1923, the Albanian Prime Minister Ahmet Zogu stated that if the Conference of Ambassadors in Paris decided to return to the question of St. Naum, then the Albanian government would not accept the decisions taken earlier for the new border with the Yugoslav state and his government would seek corrections for some territories that had been seceded from Albania in favor of the Serbo-Croatian-Slovenian Kingdom.

